



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1809/13 prot.

Pogradec, më 25.04 2024

VENDIM

Nr. 50, DATË 24/04 /2024

PËR

Heqjen nga kontabiliteti, dhe lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, të vendstrehimit 27, që i korrespondon pronës me numur 59 "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagjen nr 2 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.1240, datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 2204/2 date 17/04/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë heqjen nga inventari ekonomik i Ndërmarrjes së Mirembajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike të vendstrehimit nr 27 që i korrespondon pronës me nr 59 me emërtimin "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagjia nr 2 Pogradec, mbi pasurine 4/229, Zona kadastrale 8581 sipërfaqja 90 m2, që me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar në Pronësi të Bashkisë Pogradec.

2. Ngarkohet Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Sektori i verifikimit titujve të pronësive dhe shpronësimeve, dhe sektori Aseteve pranë Drejtorisë së Financave që në zbatim të ligjit nr 10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditesimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Angjesisë Shtetërore të Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec, të vendstrehimit nr 27 që i perket pronës me nr 59 me emërtimin "Vëndstrehim" me vendodhje në lagjen nr 2 Pogradec.

3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARË E KESHILLIT

Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 18 vota

2. Vota Pro 18

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 25.04.2024

